

# AKT THEMELIMI I SHOQERISE "JUNIK" SH.P.K.

## NENI 1

Formohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emertimin JUNIK sh.p.k. me ortak te vetem Dede Malutaj, i biri i Markut dhe i Katrines, dtl. 1962, lindur ne Iballe te Pukes dhe banues ne Kamez Tirane.

## NENI 2

Selia e shoqerise eshte ne Kamez Tirane.

## NENI 3

Kohezgjatja e shoqerise eshte mbi 10 vjet.

## NENI 4

Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise eshte ne fushen e shfrytezimit dhe te perpunimit te lendes drusore, shfrytezimit te pyllit, te tregtimit te lendes drusore me shumice e pakice, mbareshtimit te pyjeve, import eksport, ne fushen e tregtimit te mallrave industriale, elektroshtepiake, bime medicinale, ushqimore me shumice e pakice importi dhe eksporti veprimtari ne fushen e turizmit, kambizem, si dhe ne fushen e ndertimit te objekteve civile industriale, bujqesore, rruge, kanalizime, ujesjellesa, vepra arti etj. transportit te mallrave si brenda dhe jashte vendit .

## NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke, qe i perket ne menyre te plote ortakut te vetem Dede Malutaj.

## NENI 6

Shoqeria "JUNIK" sh.p.k. administrohet dhe drejtohet nga nje administrator i vetem qe me ane te ketij akti emerohet z.Beniamin Nallbani, qe eshte perfagesuesi i shoqerise.

## NENI 7

Struktura, organet dhe modalitetet e tjera pasqyrohen ne statut, qe se bashku me kete akt perbejne nje teresi te vetme e te pandare dhe qe miratohet nga ortakut i vetem.

## NENI 8

Fitimi i realizuar i perket teresisht ortakut te vetem e administratorit sipas dispozitave te statutit.

Viti i pare ushtrimor mbyllet me 31 dhjetor 1995.

## NENI 9


Per cdo gje tjeter qe nuk gjen pasqyrim ne kete akt dhe as ne statut, zbatohen dispozitat, vendimet dhe ligjet ne fuqi.

## NENI 10

Akti themelues perpilohet ne 3 (tre) kopje origjinale, te barasvlefshme duke mbetur nje kopje si pjese e dokumentacionit te formimit te shoqerise.

Tirane, me 19.04.1995

ORTAKU I VETEM - ADMINISTRATOR  
/Dede Malutaj/



# S T A T U T

## I SHOQERISE "JUNIK" SH.P.K.

KAPITALI THEMELTAR : 100.000 leke  
ORTAKU I VETEM : DEDE MALUTAJ

### KREU I

EMERTIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISE, QENDRA, JETEGJATESIA

### NENI 1

Ne baze te ligjit nr.7512, date 10.08.1991 " Per sanksionimin e mbrojtjen e prones private, te nismes se lire, te veprimtarive private, te pavarura dhe privatizimit" dhe ligjes nr. 7638, date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare" ortaku i vetem Dede Malutaj, me vullnetin e tij te lire krijon shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "JUNIK" shpk,

Shoqeria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar. Ajo eshte person juridik shqiptar dhe zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe normat e akteve te saj themeluese.

Shoqeria pergjigjet perpara te treteve me kapitalin e saj themeltar, deri ne kufi te ketij te fundit.

### NENI 2

Shoqeria ka objekt te veprimtarise se saj ne fushen e e shfrytezimit dhe te perpunimit te lendes drusore, shfrytezimit te pyllit, te tregtimit te lendes drusore me shumice e pakice,mbareshtimit te pyjeve, import eksport, ne fushen e tregtimit te mallrave industriale, elektroshtepiake, bime medicinale,ushqimore me shumice e pakice importi dhe eksporti veprimtari ne fushen e turizmit, kambizem, si dhe ne fushen e ndertimit te objekteve civile industriale, bujqesore, rruge, kanalizime, ujesjellesa, vepra arti etj. transportit te mallrave si brenda dhe jashte vendit .

NENI 3

Shoqeria e ka qendren ne Kamez Tirane  
Me vendimin e saj shoqeria mund te krijoje qendra dytesore, si  
filiale, agjenci apo perfaqesi.

NENI 4

Jetegjatesia e shoqerise eshte mbi 10 vjet.

Me vendim te ortakut te vetem apo kur verifikohen rrethana te  
tilla, kur shperndarja e shoqerise urdherohet shprehimisht nga  
ligja, shoqeria mund te shperndahet perpara ketij afati.

KREU II

KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke.

Ai i perket teresisht ortakut te vetem, eshte nenshkruar e  
shlyer prej tij teresisht ne para.

Kapitali i shoqerise perbehet nga pasuria e palujtshme e  
ortakut sipas vendimit gjyqesor. Kapitali mund te shtohet apo  
pakesohet sipas vendimit te ortakut te vetem (apo asamblese) por  
gjithnje brenda kufijve minimale te percaktuar nenin e mesiperm.

Me vendim te ortakut te vetem, i cili regjistroheshet ne Librin  
e Shoqerise, kapitali mund te ndryshohet.

Kapitali themeltar i shoqerise nuk mund te perfaqesohet ne  
letra me vlere te tregtueshme apo sherbime.

NENI 6

Kapitali themeltar eshte i ndare ne kuota nga 1000 leke  
secila. Per transferimin e tyre ne cdo forme apo tek cdo subjekt  
kompetent eshte ortaku i vetem.

NENI 7

Shoqeria ka te drejte te lere peng nje pjese te kapitalit te  
saj themeltar. Ne rast shitje te detyruar te pjeseve te lena peng,  
pengmarresi do te pranohet si person te cilit i jane transferuar

pjese te kapitalit themeltar me perjashtim te rasteve kur shoqeria preferon t'i ribljeje keto pjese e te deklaraje zvogelimin e mundshem te kapitalit te saj themeltar.

### KREU III

#### ORGANET E SHOQERISE, ADMINISTRIMI

##### NENI 8

Ortaku i vetem eshte organi me i larte i shoqerise. Atij i takojne kompetencat qe ne ligjen "Per shoqerite tregtare" i jane dhene Asamblese se Ortakeve.

Vendimet e ortakut te vetem regjistrohen ne Librin e Shoqerise.

Asambleja apo ortaku i vetem mund te vendosin qe ne nje keshill te perbere nga nje numer cift anetaresh, vota e presidentit te jete decizive ne rast mosmarreshesh.

### KREU IV

#### KESHILLI ADMINISTRATIV

##### Neni 9

Per heqjen dore ose per shkaqe te tjeta te moskostituimit te keshillit administrativ, ai konsiderohet i shkarkuar dhe asambleja apo ortaku i vetem duhet te emeruje nepermjet nje akti te vecante keshillin e ri.

##### Neni 10

Deri ne nje vendim te kundert te ortakut te vetem apo asamblese kur ka me shume se nje ortak, adm inistratori ose keshilli administrativ nuk kane asnje pengese per administrimin normal te shoqerise per arritjen e objektiveve te saj ne baze te nenit 5 te ligjit nr.7638.

##### Neni 11

Keshilli zgjedh nga radhet e tij presidentin dhe nje sekretar.

##### Neni 12

Keshilli mblidhet prane selise se shoqerise ose dhe ne vende te tjera sa here qe presidenti e cmon te nevojshme ose kur eshte bere kerkese me shkrim se paku nga nje prej anetareve.

##### Neni 13

Keshilli mblidhet nga presidenti nepermjet nje letre te derguar administratoreve se paku tre dite perpara e ne raste te jashtezakonshme edhe me telegram.

##### Neni 14

Per vlefshmerine e vendimeve te keshillit kerkohet prezenca e shumices se anetareve te tij.

Vendimet merren me shumice absolute te votave te atyre qe jane prezent.

KREU V  
ADMINISTRATORI I VETEM, ADMINISTRIMI

Neni 15

Shoqeria administrohet sipas vendimit te asamblese se zakonshme aktualisht nga ortakut i vetem, nga nje administrator ose nga nje keshill administrativ i perbere nga 2-7 anetaresh, edhe pse jo ortakut, te zgjedhur per nje periudhe qe ajo e fikson ne aktin e emerimit.

Ne rast se shoqeria do te administrohet nga nje keshill administrativ te perbere nga nje numer cift anetaresh, ne rast numri votimi te barabarte emerohet nje administrator i deleguar, i cili ne rast revokimi rrezon tere keshillin administrativ.

Asambleja apo ortakut i vetem, mund te vendosin qe ne nje keshill te perbere nga nje numer cift anetaresh, vota e presidentit te jete dezive ne rast mosmarreshjesh

Neni 16

Administratori i vetem eshte i veshur per administrimin e shoqerise me te gjitha fuqite per nje administrim normal te shoqerise duke ju rezervuar administrimi i jashtezakonshem i asamblese se ortakut apo ne rastin tone ortakut te vetem.

Neni 17

Deri ne vendim te kundert te ortakut te vetem apo te asamblese, administratori muind te kryeje cdo veprim apo akt qe eshte ne interes te shoqerise.

KREU VI

PERFAQESIMI I SHOQERISE

Neni 18

Administratorit te vetem apo presidentit te Keshillit administrativ i perkasin atributet e perfaqesimit te shoqerise. Presidenti i keshillit mund te ekzekutoje te gjitha vendimet e keshillit sa here qe nuk eshte vendosur e kunderta.

Cdo i interesuar mund te kerkoje ne Gjykatën e Rrethit Tirane anulimin e vendimeve te ortakut te vetem te marra ne kundërshtim me dispozitat ligjore dhe normat e ketij statuti.

KREU VII  
BILANCI DHE TE ARDHURAT

NENI 19

Viti ushtrimor mbyllet me 31 dhjetor te cdo viti. Ne fund keshilli ose administratori i vetem procedon per pergatitjen e bilancit me llogarite perkatese te humbjeve dhe fitimeve

Neni 20

Te ardhurat neto, pasi zbritet nje shume per rezerven ligjore ne masen jo me pak se 5 % deri ne gjymen e kapitalit shoqeror, i perkasin ortakut te vetem apo ortakeve ne masen e pjesemarrjes se tyre ne kapitalin shoqeror.

Neni 21

Pagesa e ortakeve do te behet ne arken e percaktuar nga administratori e te pranuar nga ortaku.

KREU VIII

MARREDHENIET E PUNES

Neni 22

Marredheniet e punes midis te punesuarve dhe punedhenesit rregullohen ne baze te kontrates se punes qe lidhet, duke respektuar dispozitat ligjore ne fuqi.

KREU IX

ZGJIDHJA DHE LIKUIDIMI

Neni 23

Ne rastin e pjesemarrjes se me shume se nje ortaku, mosmarreshjet midis tyre zgjidhen nga Gjykata e rrethit Tirane.

KREU X

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 24

Shoqeria JUNIK shpk fiton personalitet juridik pas regjistrimit te saj ne regjistrin e personave juridik prane Gjykates se Rrethit Tirane.

Neni 25

Per cdo gje qe nuk eshte e shprehur ne kete statut zbatohen dispozitat ligjore ne fuqi.

ORTAKU I VETEM - ADMINISTRATOR  
/ DEDE MALUTAJ/

